

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shkurt

2023

mars 2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shkurt

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, mars 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përforcuara

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkruës, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit shkurt 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i tetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.


Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Monitorimi gjatë muajit shkurt 2023 tregon se në këtë periudhë njëmuajore më së shumti publikime keqinformuese ka pasur në kategorinë vlerësuese “Clickbait” me 26%, e cila pasohet nga kategoria “Dezinformatë” me 18% dhe “Lajm i rremë” me 14%. Ndërsa, në muajin paraprak monitorues (janar 2023), numri më i madh i keqinformimeve ishin vlerësuar në kategorinë e dezinformatave dhe atë të clickbait.



26% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin “Clickbait”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1

1.1 01. Clickbait

Publikimet keqinformuese të vlerësuara në këtë kategori kanë trajtuar më së shumti çështje sociale dhe të kronikës së zezë, si dhe në numër të vogël publikime në fushën politike, të sigurisë dhe sundimit të ligjit. Temat e trajtuara në këta artikuj keqinformues janë disa publikime të paqarta për vrasje, çmimet, energjia elektrike, rritja e pagave, liberalizimi i vizave, Gjykata Speciale etj. Shumica e publikimeve në kuadër të kësaj kategorie janë krijuar e shpërndarë nëpër mediat reale dhe shumë më pak në portale të dyshimta dhe media sociale, ndërsa të gjitha prej tyre janë publikuar në gjuhën shqipe.

03. Lajm i rremë

Në kategorinë e lajmeve të rreme temat e raportuara nga mediat për kronikën e zezë kanë qenë ndër artikujt kryesorë keqinformues, si dhe disa artikuj në fushën e politikës, siç janë ato për tërmetin në Turqi dhe Siri, marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë, keqinformime për kryeministrin Albin Kurti etj. Këto lajme të rreme janë publikuar kryesisht në mediat sociale, në gjuhën shqipe.

05. Përmbajtje e paverifikuar

Artikujt me përmbajtje keqinformuese të kronikës së zezë kanë qenë temat kryesore të publikuara edhe në këtë kategori. Në këta artikuj janë trajtuar tërmeti në Turqi dhe për një tërmet tjetër, lëkundjet e të cilit ishin dëgjuar edhe në Kosovë, por me epiqendër në Rumani, ndërsa mediat kishin ngritur pretendime të paverifikuara se ka ndodhur në Kosovë, si dhe publikime të tjera për aksidente dhe Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Shumica prej tyre janë publikuar në mediat reale dhe mediat sociale.

02. Dezinformatë

Edhe në këtë kategori kanë mbizotëruar publikime keqinformuese të kronikës së zezë, pasuar nga kuriozitetet, politika, siguria e shëndetësia, të cilat trajtojnë temat të ndryshme, si tërmeti në Turqi, moti, lija e majmunëve, zhvillimet në veriun e Kosovës etj. Shumica e artikujve keqinformues, të vlerësuar si dezinformatë, janë publikuar kryesisht në gjuhën shqipe, në portale të dyshimta dhe media sociale, si dhe në numër më të vogël në mediat reale.

04. Mashtrim

Gjatë muajit shkurt 2023, publikimet keqinformuese që kanë marrë vlerësime në këtë kategori i përkasin fushës së shpalljeve, asaj sociale dhe showbiz-it lidhur me shitblerje, kredi, infrastrukturë, lidhje dashurie etj. Publikimi dhe shpërndarja e këtyre publikimeve, më së shumti është bërë në mediat e dyshimta dhe mediat sociale në gjuhën shqipe.

06. Teori konspirative

Artikujt keqinformues të kësaj kategorie kanë trajtuar tema të ndryshme në fushën e kurioziteve dhe kulturës, të shpërndara nga faqe të ndryshme në mediat sociale.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë “Gabim”, “Manipulim i fakteve”, dhe nga kombinimi i vlerësimeve “Clickbait / Gabim”. Në kuadër të këtyre kategorive janë trajtuar tema politike, të sigurisë, sundimit të ligjit, shëndetësisë dhe sportit në Kosovë.

2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Në krahasim me muajin janar 2023 dhe muajt tjerë monitorues të vitit 2022, kur temat politike dhe të sigurisë kishin dominuar pashmangshëm në raportimet e mediave, matjet për këtë muaj monitorues (shkurt 2023) kanë vënë në dukje se publikimet për kronikën e zezë kanë qenë temat kryesore, ndërsa ato politike në vendin e dytë, derisa për çështje të sigurisë kishte dukshëm më pak publikime keqinformuese. Kjo mund të jetë për shkak se gjatë këtij muaji ka pasur zhvillime më shumë në fusha të tjera se sa në ato të politikës dhe sigurisë, ndërsa mediat i kanë kushtuar më tepër rëndësi atyre temave përkatëse.

Si pasojë e këtyre zhvillimeve në fusha tjera, tema kryesore rreth të cilave mediat kanë publikuar dhe shpërndarë artikuj keqinformues janë ato për tërmetin në Turqi, ngjarje që ndërlidhen me vrasje, keqinformime për kryeministrin Albin Kurti, shitblerje, ndërsa kishte pasur dukshëm më pak raportime për komunat me shumicë serbe, marrëdhëniet Kosovë-Serbi etj. Këto keqinformime janë publikuar dhe shpërndarë në mediat reale, mediat sociale dhe portale të dyshimta kryesisht në gjuhën shqipe, ndërsa artikujt me tematikë politike dhe të sigurisë, edhe pse të pakta në numër, janë shpërndarë nga mediat në gjuhën serbe.



43% e temave kryesore kanë qenë për tërmetin në Turqi, vrasje, kryeministrin Kurti, programin Big Brother në Shqipëri, komunat me shumicë serbe etj.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Aktivitetet monitoruese tregojnë se fokusi i mediave (qoftë ato reale, të dyshimta apo mediave sociale) në muajin shkurt 2023 ka qenë në temat jashtë sferës së politikës dhe sigurisë për dallim me muajt paraprakë, në varësi të dinamikës së zhvillimeve në fusha të caktuara. Siç vërehet në figurën e mësipërme, përmbajtjet keqinformuese rreth kronikës së zezë, veçanërisht ato për tërmetin në Turqi dhe Siri, si dhe lëkundjet e tokës në Kosovë, me epiqendër në Rumani në muajin shkurt dhe disa raportime për vrasje, janë temat rreth të cilave mediat kanë publikuar e shpërndarë më së shumti keqinformime. Gjithashtu, mediat kishin publikuar keqinformime tjera për kryeministrin Kurti dhe për shpallje që ndërlidhen me shitblerje të ndryshme.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga mediat e ndryshme, sipas matjeve të “hibrid.info” përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Tërmeti në Turqi

Në këtë temë janë shpërndarë artikuj keqinformues në kategoritë e lajmeve të rreme, përmbajtjes së paverifikuar dhe dezinformatës nga mediat në gjuhën shqipe, kryesisht nga media sociale dhe media reale, si dhe më pak nga portale të dyshimta. Në këto raportime keqinformuese të mediave janë shpërndarë artikuj pa mbështetje në fakte lidhur me tërmetin në Turqi dhe janë dhënë pamje e imazhe të cilat nuk kanë korresponduar më këtë fatkeqësi natyrore në Turqi, por në vende të tjera.

03. Kryeministri Kurti

Disa faqe e profile në media sociale, si dhe media të dyshimta në gjuhën shqipe, gjatë muajit shkurt 2023, kishin shpërndarë dezinformata, lajme të rreme dhe shtrembërim të fakteve ndaj kryeministrit Albin Kurti. Përmes këtyre artikujve pretendohet pa fakte se Kurti ka shpenzuar dhjetëra mijëra euro për mobilie të zyrës, se do të japë dorëheqje pas takimit në Bruksel për dialogun Kosovë-Serbi dhe citohej në mënyrë të shtrembëruar deputeti Driton Selmanaj të ketë deklaruar se Kurti më mirë di të flasë serbisht sesa shqip.

02. Vrasje

Mediat reale në gjuhën shqipe, edhe këtë muaj, kanë publikuar e shpërndarë disa artikuj keqinformues për vrasje, në kuadër të kronikës së zezë, që janë vlerësuar si clickbait. Në bazë të titujve të këtyre publikimeve nuk është e qartë vendndodhja e këtyre vrasjeve dhe vetëm në përmbajtje të tekstit të këtyre publikimeve qartësohet se këto vrasje kanë ndodhur jashtë Kosovës. Publikime të tilla janë shpeshtuar nga mediat e Kosovës, madje nga portale lajmesh të regjistruara në Kosovë, të cilat mund t'i dezinformojnë lexuesit se këto ngjarje kanë ndodhur në Kosovë.

04. Shitblerje


Media të dyshimta në gjuhën shqipe kanë publikuar artikuj keqinformues të vlerësuar si mashtrime duke bërë shpallje për shitblerje të ndryshme. Në këto publikime kishte shpallje të rreme të apartamenteve në Greqi dhe për shitje të banesës me çmim joreal.

Llojet e fushave

Gjatë muajit shkurt 2023, mediat kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese për kronikën e zezë me 30%, e cila pasohet nga keqinformimet me përmbajtje politike prej 20% dhe fusha sociale me 12%. Kjo është hera e parë kur artikujt keqinformues që i përkasin kronikës së zezë janë në vendin e parë dhe mbizotërojnë në mënyrë të pakrahasueshme me fushat tjera, si politika, çështjet sociale dhe siguria, të cilat në muajin paraprak (janar 2023) ishin fushat kryesore të keqinformimit në Kosovë.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Artikujt që kanë trajtuar përmbajtjet e kronikës së zezë janë publikuar kryesisht në gjuhën shqipe dhe atë në mediat reale dhe në mediat sociale, ndërsa në numër shumë më të vogël nga portalet e dyshimta. Këto publikime janë vlerësuar si lajme të rreme, përmbajtje e paverifikuar, clickbait dhe dezinformatë, të cilat kanë trajtuar kryesisht keqinformime për tërmetin në Turqi dhe Siri, pretendimet e pavërteta se Kosova ishte goditur nga tërmeti, ndërsa vetëm ishin dëgjuar lëkundje të tokës që kishte epiqendër Rumaninë, artikuj për vrasje, aksidente etj.

Ndërsa, artikujt me përmbajtje keqinformuese në fushën politike kanë trajtuar tema të ndryshme, si për kryeministrin Kurti, Asociacionin e komunave me shumicë serbe, komunitat me shumicë serbe në Kosovë, marrëdhëniet Kosovë-Serbi, liberalizimin e vizave etj. Pjesa më e madhe këtyre artikujve janë publikuar dhe shpërndarë në gjuhën shqipe nga mediat reale, por kishte edhe publikime nga mediat në gjuhën serbe në pretendimet e tyre të pavërteta sa i përket zhvillimeve në Kosovë. Artikujt keqinformues me përmbajtje politike janë vlerësuar si manipulim i fakteve, lajme të rreme, clickbait dhe dezinformata.



85% e përmbajtjeve keqinformuese ndërlidhen me kronikën e zezë, fushat politike, sociale, kuriozitetet, shpalljet dhe çështjet e sigurisë.

Llojet e publikuesve


4

Në këtë raport monitorues janë paraqitur komponentë të reja për matjen e llojeve të publikuesve që krijojnë dhe shpërndajnë artikuj keqinformues rreth Kosovës. Përveç monitorimit të artikujve keqinformues që krijohen e shpërndahen nga mediat reale dhe portalet dyshimta, hybrid.info ka shtuar edhe mediat sociale (Facebook, TikTok dhe Youtube), të cilat janë me peshë lidhur me temën e keqinformimit dhe ushtrojnë ndikim të madh tek opinioni publik dhe lexuesit. Ndonëse ato paraqiten për herë të parë në këtë raport, mediat sociale në vazhdimësi janë monitoruar nga ekipi hulumtues i hybrid.info, si pjesë e metodologjisë për kontrollin e fakteve të publikimeve me përmbajtje keqinformuese.

Sipas të dhënave monitoruese për muajin shkurt 2023, kuptohet se gjatë këtij muaji, në mediat sociale, janë publikuar e shpërndarë më së shumti publikimeve keqinformuese prej 38% nga media, profile, faqe e kanale të ndryshme në mediat sociale. Ato pasohen nga mediat reale prej 37% (dallimi është një përqind me mediat sociale) dhe portalet e dyshimta me 25%.


DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE

Portale të dyshimta
25%



Media sociale
38%


Media reale
37%



38% e krijuesve dhe publikuesve të përmbajtjes keqinformuese janë faqe dhe profile të ndryshme në mediat sociale.

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Kjo matje, e cila paraqitet për herë të parë në raportet monitoruese të keqinformimit, tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues që janë monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhën serbe.

Sipas monitorimit për muajin shkurt 2023, mediat në gjuhën shqipe kanë krijuar e shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 92% lidhur me zhvillimet në Kosovë, ndërsa mediat në gjuhën serbe vetëm 8%. Kjo përqindje e ulët e publikimeve në gjuhën serbe shpjegohet nga fakti se gjatë këtij muaji monitorues (shkurt 2023) kishte pasur dukshëm më pak zhvillime në Kosovë në fushën politike e të sigurisë. Si rrjedhojë e kësaj, ka pasur më pak publikime të këtyre mediave për Kosovën, marrë parasysh se fokusi i mediave në gjuhën serbe për të krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese në raport me Kosovën është kryesisht i ndërlidhur me çështjet politike dhe të sigurisë, në kontekst të marrëdhënieve aktuale mes Kosovës dhe Serbisë.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe dhe serbe. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet e mediave në gjuhën shqipe

Pothuajse të gjithë artikujt gjatë këtij muaji janë publikuar nga mediat në gjuhën shqipe, qoftë në media reale, media sociale apo portale të dyshimta. Artikujt keqinformues në këtë kategori janë vlerësuar më së shumti si clickbait, dezinformatë, mashtrim dhe lajm i rremë, duke shpërndarë përmbajtje të kronikës së zezë, politikës, çështjeve sociale, kuriozitetë dhe shpallje të ndryshme. Ndonëse mediat në gjuhën shqipe gjatë këtij muaji kanë raportuar për këto tema, megjithatë të gjitha ato (mediat reale, mediat sociale dhe portalet e dyshimta) kanë shpërndarë keqinformime edhe për çështje të ndryshme politike, por në numër më të vogël kur krahasohen të dhënat me muajt paraprakë monitorues dhe shumë më pak për temën e sigurisë.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe


Të gjitha publikimet me përmbajtje keqinformuese të mediave në gjuhën serbe janë publikuar e shpërndarë nga mediat reale. Ato janë në fushën politike dhe të sigurisë lidhur me dialogun Kosovë-Serbi dhe pretendime pa fakte se disa incidente në komunat me shumicë serbe në Kosovë janë të motivuara etnikisht. Publikimet e mediave serbe, edhe pse të pakta në numër, janë vlerësuar në kategoritë e manipulimit të fakteve, përmbajtjes së paverifikuar, lajmeve të rreme dhe dezinformatave.

Llojet e mediave sociale

Në këtë raport monitorues për muajin shkurt 2023, hibrid.info për herë të parë analizon të dhëna më të detajuara sa i përket artikujve keqinformues të publikuar dhe shpërndarë në mediat sociale nga publikues të ndryshëm të këtyre mediave. Në këtë rast analizohen vetëm artikujt e publikuar në mediat sociale (pa i përfshirë mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Siç shihet, gjatë këtij muaji monitorues, Facebook ka qenë media kryesore sociale për shpërndarjen e artikujve keqinformues lidhur me ngjarjet në Kosovë prej 64%. Ajo pasohet nga dy mediat tjera sociale, Tik Tok me 29% dhe YouTube me 7%.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Ky seksion pasqyron ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, profileve, mediave dhe kanaleve të ndryshme që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale, të cilët i shfrytëzojnë ato për përhapjen e keqinformimit dhe për çështje tjera.

Figura e mëposhtme tregon se, gjatë muajit shkurt 2023, faqet në Facebook dhe TikTok kanë shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 54%, e cila pasohet nga profilet në TikTok me 25%. Ndërsa, vetëm 14% e publikimeve keqinformuese në Facebook është shpërndarë nga mediat dhe 7% të tjera nga kanale të ndryshme në YouTube.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE



Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese.

01. Facebook

Faqet – Pothuajse të gjitha publikimet e këtyre faqeve janë publikuar në Facebook. Këto publikime janë në gjuhën shqipe dhe në fusha të ndryshme, si politika, shpallje, kronikë e zezë, sociale dhe siguri që kanë marrë më së shumti vlerësime clickbait, mashtrim, dezinformatë dhe lajme të rreme.

Mediat – Numri i mediave që kanë publikuar artikuj keqinformues në mediat sociale (Facebook) është i vogël në krahasim me ndërveprimin e faqeve dhe profileve në media sociale. Përmbajtja e artikujve të mediave që kanë publikuar në Facebook është në gjuhën shqipe për kronikën e zezë lidhur me tërmetin në Turqi dhe që janë vlerësuar si lajme të rreme, dezinformatë dhe përmbajtje e paverifikuar.

02. TikTok

Artikujt keqinformues të shpërndara nga profile në TikTok janë në gjuhën shqipe të vlerësuar në kategoritë e teorisë konspirative, manipulimit të fakteve, dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Shumica e këtyre artikujve me tematika të ndryshme janë kuriozitete dhe në përqindje më të vogël i përkasin kronikës së zezë, kulturës dhe politikës.

02. YouTube


Publikimet keqinformuese gjatë këtij muaji në kanalet e YouTube janë në formën e video-materialeve lidhur me tërmetin në Turqi dhe Siri që kanë marrë vlerësime të dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Edhe kanalet në këtë rrjet social kanë publikuar më pak përmbajtja keqinformuese në krahasim me publikuesit tjerë të mediave sociale.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Raporti monitorues mat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura në bazë të monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

Si pasojë e fokusit të mediave në fusha dhe tema të tjera gjatë muajit shkurt 2023, monitorimi për këtë muaj tregon se institucionet e Kosovës dhe organizata të tjera vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë nuk kanë qenë të përfolura nga mediat për këtë periudhë njëmuajore. Për këtë arsye edhe nuk ka matje statistikore sa i përket institucioneve për këtë muaj, por vetëm për personalitet më të përfolura sipas figurës në vijim.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Edhe në muajin shkurt 2023, njëjtë si në muajt paraprakë monitorues, mediat në gjuhën shqipe dhe serbe kanë përfolur më së shumti kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për tema në fushën politike dhe të sigurisë. Artikujt e mediave në gjuhën serbe (që të gjitha janë media reale) kanë përfolur Kurtin në lidhje me Asociacionin e komunave me shumicë serbe dhe për komunat me shumicë serbe në Kosovë duke shpërndarë artikujt me përmbajtje të pa verifikuar dhe manipulim të fakteve. Ndërsa, publikuesit në mediat sociale dhe mediat e dyshimta në gjuhën shqipe kanë shpërndarë dezinformata, lajme të rreme dhe manipulim të fakteve ndaj kryeministrit Kurti për çështje të ndryshme.

Për shkak se nuk ka pasur shumë përmbajtje keqinformuese që ndërlidhen me ngjarjet politike, në listën e figurave të përfolura kanë munguar personalitetet politike.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 28 shkurt 2023.

Përfundime

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit shkurt 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Monitorimi për muajin shkurt 2023 tregon se mediat kanë krijuar e shpërndarë më së shumti artikuj keqinformues në kategoritë clickbait me 26%, pasuar nga dezinformatat me 18% dhe lajmet e rreme me 14%. Vlerësime “Clickbait” kanë marrë më së shumti publikimet në fushën sociale dhe të kronikës së zezë, si dhe temat politike, të sigurisë dhe sundimit të ligjit, siç janë disa artikuj të paqartë për vrasje, çmimet, energjia elektrike, rritja e pagave, liberalizimi i vizave, Gjykata Speciale etj. Në kategorinë “Dezinformatë” kanë dominuar keqinformimet e kronikës së zezë, kuriozitetet, politika, siguria e shëndetësia, të cilat trajtojnë tërmetin në Turqi, motin, lijën e majmunëve, zhvillimet në veriun e Kosovës etj. Edhe në kategorinë “Lajme të rreme”, publikimet kryesore janë për tërmetin në Turqi dhe disa artikuj që trajtojnë tema politike.

Gjatë muajit shkurt 2023, temat kryesore të keqinformimit kanë qenë tërmeti në Turqi, raportime të paqarta për vrasje, keqinformime për kryeministrin Albin Kurti, shitblerje etj. Ajo që e dallon këtë muaj monitorues është se ka pasur dukshëm më pak raportime për veriun e Kosovës, komunat me shumicë serbe dhe marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Këto publikime janë krijuar dhe shpërndarë në mediat reale, mediat sociale dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe, ndërsa artikujt me tematikë politike dhe të sigurisë janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe, megjithëse ato ishin në përqindje të vogël krahasuar me periudhat e mëhershme monitoruese. Ndërsa, fushat kryesore të keqinformimit janë kronika e zezë prej 30%, politika me 20% dhe çështjet sociale 12%.

Pjesa më e madhe e artikujve keqinformues gjatë këtij muaji janë publikuar në mediat sociale prej 38%, të cilat pasohen nga mediat reale me 37% dhe portalet e dyshimta 25%. Sa i përket mediave sociale, në Facebook (64%), TikTok (29%) dhe YouTube (7%) janë shpërndarë përmbajtjet keqinformuese. Të gjithë artikujt e mediave sociale janë në gjuhën shqipe që trajtojnë tema të ndryshme nga kronika e zezë, kuriozitetet dhe politika që kanë marrë vlerësime të lajmeve të rreme, dezinformatës dhe teorisë konspirative. Pos kësaj, mbi 90% e publikimeve këtë muaj janë krijuar nga mediat në gjuhën shqipe dhe vetëm 8% nga ato në gjuhën serbe. Artikujt keqinformues të publikuar nga mediat në gjuhën shqipe kanë trajtuar tema të ndryshme në kuadër të kronikës së zezë, politikës, çështjeve sociale, kuriozitetet dhe shpallje të ndryshme. Ndërkaq, mediat në gjuhën serbe kanë raportuar për keqinformime në fushën politike dhe të sigurisë lidhur me dialogun Kosovë-Serbi dhe pretendime pa fakte se disa incidente në komunat me shumicë serbe në Kosovë janë të motivuara etnikisht.

Në krahasim me periudhat e mëhershme monitoruese, gjatë këtij muaji (shkurt 2023), mediat dhe publikuesit e artikujve keqinformues nuk kanë përfolur ndonjë institucion. Ndërsa, kryeministri Albin Kurti vazhdon të jetë edhe këtë muaj më i përfoluri nga portalet e dyshimta dhe publikuesit e mediave sociale në gjuhën shqipe, si dhe nga media reale në gjuhën serbe për tema në fushën politike dhe të sigurisë.

HIBRIDO.INFO